

**V E N D I M**

**Nr. 91 Date 06.08. 2008**

**PER  
LICENSIMIN E SHOQERISE “MUSO HEC QYTEZE” SH.P.K**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pika 1, germa a, dhe 8, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, te ndryshuar, neneve 5, 13 dhe 14 te “Rregullores per Procedurat e Licensimit”, te miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.21 datë 04.04.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.08.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqeria “MUSO HEC QYTEZE ” sh.p.k, per tu licensuar ne aktivitetin e ndërimit, instalimit, shfrytëzimit si dhe prodhimit te energjise elektrike nga HEC Qyteze,

**Konstatoi se:**

1. Fillimi i procedurave per shqyrtimin e aplikimit te “MUSO HEC QYTEZE” sh.p.k, ka nisur me marrjen e vendimit nr. 43 date 11.04.2008.
2. Ligji nr. 9913, date 5.5.2008 ” Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” nuk parashikon te kete fuqi prapavepruese per aplikimet e paraqitura para hyrjes ne fuqi te ketij ligji.
3. Shoqeria eshte mbajtese e nje kontrate koncesioni te formes BOT, me nje afat 30 vjeçar per kete hidrocentral.
4. Shoqeria ka paraqitur te plote dokumentacionin e percaktuar ne Rregulloren e Procedurave te Licensimit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



Per sa konstatuar, Bordi i Komisionereve te ERE-s,

**Vendosi:**


1. Të licensoj shoqerine “MUSO HEC Qyteze” sh.p.k ne aktivitetin e ndërtimit, instalimit, shfrytëzimit si dhe prodhimit te energjise elektrike nga HEC Qyteze per nje kohezgjatje prej 30 vjet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit te Tregut te njoftoje aplikuesin per vendimin e Bordit te Komisionereve te ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**ENTI RREGULLATOR I**  
**SEKTORIT TË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE**  
Bordi i Komisionereve



**Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,**  
**VENDIMIN**

**Nr.91 date 06.08.2008**

**PER**  
**LICENSIMIN E SHOQERISE "MUSO HEC Qyteze" SH.P.K**

**Anëtarët e Bordit**

|                          | Pro   | Kundër |
|--------------------------|-------|--------|
| <b>Bujar Nepravishta</b> | _____ | _____  |
| <b>Entela Shehaj</b>     | _____ | _____  |
| <b>Ardian Haçi</b>       | _____ | _____  |
| <b>Abaz Aliko</b>        | _____ | _____  |